VENDIM
Nr.48, datë 18.4 2008

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK "PROJEKTI KAPPET") SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 9, pika 1 dhe pika 2, germa "a", të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007; nenit 18, pika 1 germa "e", të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007 dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.33, datë 21.3.2008 "Për fillimin e procedurave, për kualifikimin e impiantit prodhues Parku Eolik "Projekti Kappet", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria HERA sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues parku eolik, "Projekti Kappet", si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e aplikimit

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues parku eolik "Projekti Kappet" si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta